

28.02.2025

**EDICIONI
NR. 03**

UBTNEWS



Shkurt, Kosova reflekton në UBT!

"Kur thonë që 'në UBT krijohen mundësi', ata flasin për të ardhmen e Kosovës, ku dijes dhe inovacionit i jepet energjia për të kaluar çdo kufi. Përkushtimi ynë nuk është vetëm në fjalë, por në vepra që lënë gjurmë në jetët e njerëzve dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt një epoke të re të dijes dhe inovacionit"

**Themeluesi dhe rektori i UBT-së
Prof. Dr. Edmond HAJRIZI**



PËRMBAJTJA

01

Shkurt, Kosova reflekton në UBT!

02

Demografia e Kosovës po plaket!

03

Shporta e shtrenjtë, xhepat e zbrazët, qytetarët bojkotojnë!

04

Ekosistemi i Kosovës në duar të teknologjive

05

Zgjedhjet e 9 shkurtit: Si ndryshimi i ri ballafaqohet me procesin zgjedhor?

06

Ndotja e ajrit: Pasojat shëndetësore, burimet dhe zgjidhjet për përmirësimin e cilësisë

07

Remote Sensing: Rritja e efikasitetit në menaxhimin e mjedisit dhe infrastrukturës në Kosovë

08

Kosova në korridorin e 'Energjisë së Rinovueshme'

Shkurt, Kosova reflekton në UBT!

Dionesa EBIBI

Në agun e përvjetorit të 17-të të Pavarësisë së Kosovës, në një kohë kur shpirti i kombit përkujton sakrificat dhe triumfet e tij, UBT, si një fortesë e dijes dhe vizionit, shpalo si një tjetër kapitull të angazhimit të tij për edukimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Në këtë ditë të shenjtë të historisë sonë, institucioni shpërbleu 166 studentë ekselentë të të gjitha fakulteteve me bursa studimi, një akt i cili jo vetëm vlerëson përkushtimin akademik, por edhe nxit gjeneratat e ardhshme që të ndërtojnë themelet e dijes mbi meritën dhe punën e palodhshme.

Në këtë odise të përparimit intelektual, këta student, dritë e shpresës për të nesërmen, me një mesatare mbi 9.0, tashmë kanë siguruar një mbështetje të rëndësishme që do t'ua lehtësojë udhën e dijes. Nuk është shpërblim; është manifest i besimit se e ardhmja e një vendi ndërtohet mbi dijen, mbi ata të rinj që nuk kënaqen me mesataren, por sfidojnë veten drejt lartësive të shkencës dhe inovacionit.

Në ceremoninë e ndarjes së bursave, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rolin jetik të arsimit cilësor në ngritjen e një shoqërie të qëndrueshme dhe të përparuar. Me një vizion largpamës, ai nënvizoi se ky shpërblim është zotim për të përkrahur dhe fuqizuar mendjet e ndritura që do të jenë themeli i zhvillimit të Kosovës.

"Kur thonë që 'në UBT krijohen mundësi', ata flasin për të ardhmen e Kosovës, ku dijes dhe inovacionit i jepet energjia për të kaluar çdo kufi. Përkushtimi ynë nuk është vetëm në fjalë, por në vepra që lënë gjurmë në jetët e njerëzve dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt një epoke të re të dijes dhe inovacionit", u shpreh Rektori Hajrizi.

UBT nderon historinë dhe kontributin për lirinë e Kosovës

Shkurti, UBT-ën e gjen edhe në një ceremoni që shndërrohet në një akord të thellë të reflektimit filozofik mbi historinë dhe ardhmërinë. Në një atmosferë solemne, ku çdo fjalë ka peshën e një epepeje kombëtare, dy figura të shquara, ish-presidenti Fatmir Sejdiu dhe filantropi Salvatore Tafuro, janë nderuar me çmimin

më të lartë institucional të UBT-së, një akt që më shumë se një ceremoni akademike është një udhëzues në labirintin e ndërjegjes kombëtare. Ky moment, në dukje simbolik, shpërfaq një përpjekje të thellë për të kuptuar lidhjen e përhershme mes sakrificës dhe ndërtimit të shtetit, mes jetës që ishte dhe jetës që ende duhet të ndërtohet.

Në këtë mjedis akademik dhe diplomatik, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, shprehu nderimin dhe vlerësimin për rolin e palodhur të dy figurave, të cilat janë pjesë e historisë së Kosovës, janë dritare që hapin rrugë për të ardhmen e vendit. E sipas tij, Sejdiu, si njeri që udhëhoqi Kosovën në momentet më vendimtare, mishëron jo vetëm vizionin e një lideri, por dhe thelbin e një kombi që di të rritet në përpjekje dhe shpresë. Tafuro, ndërkaq, është përfaqësues i një humanizmi që ka dalë përtej fjalëve dhe ka hyrë në sferën e veprës, duke e dashur Kosovën jo për asnjë fitim personal, por për përkushtimin pa kushte.

Fjalët e Sejdiut nga UBT, të mbushura me emocion, ndihmojnë në ndriçimin e përvojshëm të historisë sonë, duke e ndarë atë në dy pjesë të pandashme: sakrifica dhe ndërtimi, Ibrahim Rugova e Adem Jashari. Historinë e Kosovës, ai e sheh si një simbiozë mes dy forcash që i dhanë formë kombit, njëri me fjalë dhe diplomaci, tjetri me luftë dhe sakrificë. Ky binom i përtejshëm është themeli mbi të cilin është ngritur shteti ynë dhe, në të njëjtën kohë, një paralajmërim për të ardhmen: se çdo akt i ndërmarrë duhet të jetë një bashkim mes idealizmit dhe realitetit, mes shpirtit dhe trupit të shtetit.

Për Tafuron, Kosova ka qenë një dashuri e heshtur, një angazhim pa kërkesa për lavdërim, por vetëm një dëshirë e pastër për të parë një vend të vogël, por të fuqishëm, të ngrihet. Mesazhi i tij nga UBT është i thjeshtë, por i thellë: se vetëm përmes dijes, punës dhe humanizmit mund të ndërtojmë një të ardhme më të mirë. Ai fton të rinjtë të shohin larg, të mendojnë thellë dhe të punojnë me pasion për të ndërmarrë udhëtimin drejt një Kosove më të fuqishme dhe më të drejtë.

Ndërtimi i shtetit nuk është një akt i vetëm, por një proces i vazhdueshëm që kërkon përpjekje dhe vizion,

kërkon pasion dhe sakrificë. Dhe UBT po punon çdo ditë për të!

UBT me Kosovën një hap përpara...

Muaji shkurt, ka sjellë një reflektim të thellë mbi atë që është arritur dhe atë që na pret përpara. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i drejtohet Kosovës me një mesazh, duke theksuar rolin kyç të arsimit dhe dijes në ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar.

“Kosova, sot, është një komb që po ecën përpara me hapa të sigurt, duke krijuar vlera dhe fortifikuar themelet e një demokracie të qëndrueshme. Arsimimi i brezave është çelësi që hap dyert e një të ardhmeje të mirë, dhe në këtë udhëtim, UBT është një shtyllë që e mbështet fort këtë transformim të madh. Ne e dimë se vetëm duke investuar në diturinë e brezave të rinj, në pasionin dhe inovacionin e tyre, mund të ndërtojmë një komb që jo vetëm do të ecë, por do të udhëheqë”, shprehet Rektori Hajrizi, duke theksuar se rruga e Kosovës është e lidhur ngushtë me fuqizimin e dijes dhe përpjekjet e pandalshme për përparim.

Përmes këtij vizioni dhe angazhimit të pandalshëm, UBT ka shënuar disa arritje të rëndësishme gjatë muajit shkurt, duke forcuar më tej rolin e saj si një urë lidhëse mes arsimit, biznesit dhe diplomacisë akademike.

Partneritet për zhvillim, UBT dhe Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane
Muaji shkurt ka sjellë një tjetër sukses të veçantë

të për UBT-ën, një ndër momentet kulmore të këtij muaji është formimi i një partneriteti të rëndësishëm me Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, një hap që sjell përmbushjen e një misioni të thellë: lidhjen e universiteteve me tregun e punës, ndihmën për ndërmarrësit dhe ofrimin e mundësive të reja për zhvillim ekonomik dhe inovacion. Marrëveshja, e firmosur nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe Kryetari i Degës së Unionit në Kosovë, Shkelzen Jusaj, e që kjo iniciativë e bën UBT një katalizator për krijimin e mundësive reale për studentët dhe për zhvillimin e ekonomisë kosovare.

Rektori Hajrizi, në fjalën e tij, shprehu bindjen e thellë se arsimit është çelësi i çdo transformimi të vërtetë. Ai theksoi se ky partneritet do të ndihmojë në organizimin e trajnimeve profesionale, do të mbështesë iniciativat e diasporës dhe do të krijojë mundësi për lidhje më të thella mes studentëve dhe komunitetit të biznesit.

Muaji shkurt, jo vetëm që ka konsoliduar më tej pozicionin e universitetit si një qendër edukimi të nivelit të lartë, por gjithashtu ka forcuar lidhjet e tij me tregun dhe sektorin privat. Ky sukses i ri është një tjetër hap drejt realizimit të vizionit të UBT-së për një të ardhme të mbështetur në dijen dhe inovacionin, ku arsimit dhe biznesi bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar zhvillim dhe përparim të qëndrueshëm.

UBT, Qendër e Certifikimeve Ndërkombëtare për Gjuhën Italiane
Edhe pse shkurti zakonisht njihet për periudhën e tij të shkurtër, në UBT ai u bë një muaj i pafund

mundësish dhe arritjesh. Një nga arritjet më të rëndësishme të këtij muaji ishte pozicionimi i UBT-së si institucioni i parë dhe i vetëm në Kosovë i autorizuar për të ofruar certifikimet ndërkombëtare CELI (Certificati di Conoscenza della Lingua Italiana). Ky hap i ri ka dhënë mundësi për studentët dhe profesionistët të certifikojnë njohuritë e tyre në gjuhën italiane, duke e pozicionuar UBT-në si një lider të certifikimeve gjuhësore në vend.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, nënvizoi se certifikimi CELI është një mundësi që i ndihmon studentët të jenë më konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës dhe të avancojnë në studimet e tyre akademike. Ky sukses ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit me ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, profesorësh e gjuhës italiane Dr. Raffaella Ritucci dhe Universitetin italian “Università per Stranieri di Perugia”.

Me një gamë të gjerë certifikimesh ndërkombëtare, përfshirë TOEFL, PSI CELT, Prometrics dhe GRE, UBT vazhdon të jetë një portë drejt suksesit global për studentët dhe profesionistët kosovarë, duke ofruar mundësinë për të marrë certifikata të njohura ndërkombëtarisht, pa pasur nevojë të udhëtojnë jashtë vendit. UBT ka shpërblyer ekselencën studentore, nderuar kontributin historik dhe ka hapur horizonte të reja për dijen dhe zhvillimin, duke kurorëzuar shkurtin me një seri arritjesh të jashtëzakonshme në fushën akademike dhe ndërkombëtarizimit.

"Kosova, sot, është një komb që po ecën përpara me hapa të sigurt, duke krijuar vlera dhe fortifikuar themelet e një demokracie të qëndrueshme. Arsimimi i brezave është çelësi që hap dyert e një të ardhmeje të mirë, dhe në këtë udhëtim, UBT është një shtyllë që e mbështet fort këtë transformim të madh. Ne e dimë se vetëm duke investuar në diturinë e brezave të rinj, në pasionin dhe inovacionin e tyre, mund të ndërtojmë një komb që jo vetëm do të ecë, por do të udhëheqë".

Prof. Dr. Edmond HAJRIZI



Demografia e Kosovës po plaket!

Në historinë e kombeve, ndryshimet demografike kanë shërbyer si tregues kyç të transformimeve shoqërore, ekonomike dhe politike. Kalimi nga periudha të dendura popullore në faza të zbrazjes demografike, nga një identitet i konsoliduar kombëtar në sfida të reja të brendshme dhe të jashtme, shpesh ndodh përmes natalitetit, migrimit dhe plakjes së popullsisë. Rënia demografike nuk është thjesht një statistikë numerike; ajo pasqyron ndryshime të thella në strukturën e një shoqërie dhe kërkon analizë të kujdesshme për të kuptuar kompleksitetin e këtij fenomeni dhe ndikimet e tij afatgjata.

Për pyetjen se çfarë faktorësh kanë kontribuar në rënien prej 8.8% të numrit të popullsisë në Kosovë që nga regjistrimi i vitit 2011, Prof. Ass. Dr. Hazer Dana, profesor universitar dhe autoritet i njohur në fushën e demografisë, ofron një përgjigje të hollësishme dhe të thellë. Ai vlerëson se, pas dy dekadash të ndryshimeve të shumta dhe sfidave të brendshme dhe të jashtme,

"Kosova ka kaluar në një periudhë të transformimeve thelbësore, rënia e numrit të popullsisë është e lidhur ngushtë me një varg faktorësh, ku ndikimi kryesor ka qenë rënia e shkallës së natalitetit dhe rritja e shkallës së emigrimit"

Prof. Ass. Dr. Hazer Dana

Kosova ka kaluar në një periudhë të transformimeve thelbësore. Sipas tij, rënia e numrit të popullsisë është e lidhur ngushtë me një varg faktorësh, ku ndikimi kryesor ka qenë rënia e shkallës së natalitetit dhe rritja e shkallës së emigrimit.

Profesor Dana konsaton se, "ndër tjerash, shoqëria kosovare ka përjetuar një shtrirje të procesit të urbanizimit, ku gjithnjë e më shumë individë kanë zgjedhur të emigrojnë, në kërkim të mundësive më të mira ekonomike dhe sociale jashtë kufijve të Kosovës". Ai vëren se numri i emigrantëve ka pasur një rritje të madhe, veçanërisht në vitin 2015, ku më shumë se 74 mijë qytetarë të

Kosovës u larguan për të kërkuar një jetë më të mirë.

Gjithashtu, një faktor tjetër që ka ndikuar në këtë fenomen është ndryshimi i strukturës ekonomike dhe sociale. Sipas profesorit, Kosova ka kaluar në një fazë ku shumë individë janë të përkushtuar në zhvillimin personal, në arsimim dhe në realizimin e qëllimeve profesionale, duke vonuar formimin e familjeve apo duke zgjedhur që të mos krijojnë më shumë fëmijë. E sipas tij, ky proces është pasojë e strukturave të reja të familjes dhe të ndryshimeve në prioritetet sociale dhe ekonomike.

Siç e thekson Dana, kjo rënie është një pasqyrë e shoqërisë që po kalon një periudhë të ndërlikuar dhe sfiduese. "Çdo shifër dhe çdo analizë që lidhet me të, përveç që na tregon një të vërtetë të dhimbshme, është gjithashtu një mundësi për të reflektuar dhe për të gjetur zgjidhje për një të ardhme më të qëndrueshme", vlerëson ai.

Nga fshati në qytet, presionet e urbanizimit dhe përshtatja sociale...

Profesori Dana vuri në theks faktin se "migrimi i brendshëm në Kosovë ka luajtur një rol të rëndësishëm në shkallën e urbanizimit". Ai theksoi se, sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, "më shumë se gjysma e popullsisë tani jeton në qytete, me një rritje të dukshme prej mbi 12% që nga viti 2011", dhe se migrimi i madh ka ndodhur nga zonat rurale në ato urbane. Për pasojë, ai thekson se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, veçanërisht nga viset kodrinore-malore dhe fshatrat periferik, kanë migruar në qytete të mëdha si Prishtina, Prizre-



Prof. Ass. Dr. Hazer Dana

ni, Peja dhe të tjera.

Dana pohon se kjo zhvendosje ka sjellë "shuarjen e shumë aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, duke përfshirë lënien e tokës pa punuar dhe zvogëlimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale", dhe se ky fenomen ka pasur ndikime të drejtpërdrejta në strukturën ekonomike dhe sociale të vendit. "Zhvendosja e popullsisë në qytetet më të mëdha ka ushtruar presion të madh në hapësirat urbane", shton ai, duke u fokusuar në mënyrën se si ky transformim ka ndikuar në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë.

Më tej, Prof. Dana vëren se, shkalla e urbanizimit ka një raport reciprok shkak-pasojës me zhvillimin ekonomik, duke shpjeguar se rritja ekonomike dhe mundësitë për një jetë më të mirë në qytete tërheqin popullsinë nga zonat rurale. Ai e lidh këtë fenomen me rritjen e fuqisë punëtore dhe diversifikimin profesional që ndihmon në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike shërbyese, tregtisë dhe industrisë. Në anën tjetër, ai thekson se urbanizimi sjell përfitime si diversitet më të madh social, kulturor dhe arsimor, por gjithashtu edhe sfida të tilla si "vështirësi në përshtatjen me realitetin urban dhe presionin e vazhdueshëm për banim, infrastrukturë dhe shërbime sociale".

Komunat serbe në veri - Pasqyrë e paqartë nga regjistrimi i ulët...

Pjesëmarrja e ulët e banorëve nga komunat me shumicë serbe në veri në proceset e regjistrimit të popullsisë paraqet një pengesë të madhe për pasqyrimin e saktë të situatës demografike në këto zona. Dana thekson se, mungesa e të dhënave reale të popullsisë në këto komuna nuk pasqyron gjendjen e vërtetë dhe ndikon në pamundësinë e krijimit të një pasqyre të plotë të strukturës demografike. Sipas tij, ky problem është shumë më i ndërlikuar, pasi mungesa e informacionit të saktë krijon vështirësi në ndërtimin e politikave të qarta dhe të drejtpërdrejta për zhvillim dhe planifikim.

Në këtë kontekst, Dana thekson se mungesa e të dhënave të sakta mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përfaqësimin politik të këtij komuniteti. "Këto të dhëna janë thelbësore për përfaqësimin administrativ dhe politik, si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional", shpjegon ai. Dhe vazhdon duke potencuar se pa një pasqyrë të saktë të popullsisë, bëhet e vështirë që ky komunitet të ketë një përfaqësim të drejtë dhe të balancuar në organet e pushtetit.

Mungesa e informacionit të saktë gjithashtu ndikon në zhvillimin ekonomik dhe urban, duke e bërë të

vështirë planifikimin e zhvillimeve infrastrukturore dhe shpërndarjen e resurseve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. “Të dhënat demografike janë thelbësore për planifikimin hapësinor dhe urban”, thotë profesori Dana, duke theksuar se një mungesë e sasisë dhe saktësisë së të dhënave mund të çojë në shpërndarje të pasaktë të resurseve dhe zhvillimeve, duke shkaktuar mungesë shërbimesh, hapësirash dhe infrastrukturës së nevojshme në këto komuna.

Një tjetër aspekt që profesori e vë në dukje është ndikimi që ka mungesa e të dhënave të sakta në qasjen ndaj fondeve ndërkombëtare. Shumë fonde ndërkombëtare mbështeten në të dhënat demografike për të vendosur kriteret për shpërndarjen e financimeve.

“Pa një pasqyrë të saktë të numrit dhe strukturës së popullsisë, komunitat në veri mund të humbasin mundësinë e përfitimit nga këto fonde, duke përfshirë ato që ndihmojnë zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës”, tha ai.

Tutje, profesori nënvizon se ky problem mund të ketë pasoja të mëdha për realizimin e studimeve të ndryshme demografike, gjeografike dhe hapësinore, duke vështirësuar të gjithë procesin e hulumtimit dhe analizës të strukturave të popullsisë në të ardhmen. Ai thekson se pa të dhëna të plota dhe të sakta, është e vështirë të krijohen politika efektive që të ndihmojnë zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në këto komuna. Kosova në prag të plakjes demografike... migrimit dhe rënies së popullsisë!

Plakja e popullsisë në Kosovë ka bërë që vendi të ballafaqohet me një sfidë të re dhe të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë. Sipas të dhënave, popullsia mbi 65 vjeç ka shënuar një rritje të konsiderueshme, duke arritur nga 6.7% në vitin 2011 në 10.97% në vitin 2024. Ky trend tregon se Kosova është në prag të hyrjes në procesin e moshnimit demografik, një proces që ka ndikime të thella në struktura ekonomike dhe sociale të shoqërisë.

Profesori universitar, Dana vuri në dukje se, “kur popullsia mbi 65 vjeç kalon 12% të popullsisë së përgjithshme, kjo tregon se vendi ka hyrë në fazën e një popullate të plakur, që ka pasojat e veta në zhvillimin afatgjatë”.

Një prej aspekteve më të rëndësishme që lidhen me plakjen e popullsisë është ndikimi në tregun e punës dhe ekonominë. Rritja e numrit të pensionistëve ka si pasojë një ngarkesë të shtuar për skemën e pensione, pasi shpenzimet publike për pensionet rriten ndjeshëm, ndërkohë që numri i individëve aktivë në tregun e punës bie.

Dana shpjegon se, “kur rritet numri i pensionistëve dhe zvogëlohet ai i individëve që kontribuojnë në sistemin e punës, kjo krijon një peshë të rëndë mbi buxhetin e shtetit dhe ndikon në stabilitetin ekonomik”.

Kur flet për procesin e plakjes së popullsisë në Kosovë, ai e sheh si një sfidë serioze që ka pasoja të mëdha në sistemin shëndetësor dhe ekonomik. Ai shprehet se “rritja e numrit të të moshuarve kërkon një kujdes shëndetësor më të madh dhe më të shpeshtë, çka e bën trajtimin e tyre më kompleks dhe me kosto më të larta për shërbimet mjekësore”. Sipas tij, kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në shpërndarjen e fondeve publike, pasi “burimet duhet të orientohen më shumë në sektorin e shëndetësisë dhe pensioneve, duke ulur mundësitë për investime në sektorët produktivë dhe inovacionin”.

Po ashtu, Dana paralajmëron për ndikimin e këtyre tendencave në zhvillimin ekonomik afatgjatë të vendit. Ai thekson se Kosova mund të përballet me “uljen e fuqisë punëtore, duke kufizuar mundësitë për rritje të vazhdueshme ekonomike dhe zhvillimin e inovacioneve.” Sipas tij, një popullsi e plakur ka mundësi më të ulëta për të kontribuar në sektorët inovativë dhe zhvillimor, duke rritur kështu sfidat për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

“Ky fenomen kërkon një planifikim

Diaspora kosovare ka një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës, dhe kjo është reflektuar edhe në regjistrimin e sivjetmë të popullsisë, ku përfshirja e mërgatës është një faktor i rëndësishëm për pasqyrimin e realitetit demografik të vendit. Më shumë se 1 milion kosovarë jetojnë jashtë vendit, dhe kontributi i tyre është shumëdimensional. Në aspektin ekonomik, diaspora ka pasur një ndikim pozitiv të dukshëm përmes punësimit në vendet e huaja, duke mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës për shumë familje në Kosovë, si dhe realizimin e të ardhurave të konsiderueshme që shpesh janë investuar në vendlindje.

Profesori thekson se, “diaspora ka ndihmuar në rritjen e kapitalit ekonomik të Kosovës, si përmes dërgesave monetare, ashtu edhe përmes investimeve në biznese dhe projekte lokale”.

Kur flet për aspektin social, thotë se diaspora ka mbajtur dhe promovuar lidhje të forta me Kosovën, duke kontribuar në ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar përmes organizatave kulturore dhe manifestimeve të ndryshme. E sipas tij, ata kanë pasur mundësi për zhvillim profesional dhe arsimor, duke sjellë në Kosovë ekspertizë dhe ide inovative që mund të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Ai vlerëson se ky fenomen ka sjellë përfitime të rëndësishme për shoqërinë kosovare, si rritja e mundësive arsimore dhe kualifikimeve profesionale, si dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve.

Megjithatë, kur ndalet dhe flet për emigrimin thotë se emigrimi ka sjellë edhe disa pasoja negative për Kosovën. Në aspektin ekonomik, largimi i fuqisë punëtore, veçanëri-

“Në aspektin social, largimi i shumë individëve ka ndikuar në familjet kosovare, duke shkaktuar pasiguri sociale dhe psikologjike, sidomos për ata që janë të ndarë nga familjet e ngushta. Për më tepër, procesi i integritimit në vendet ku jetojnë kosovarët është një sfidë e madhe, pasi shumë prej tyre përballen me vështirësi të adaptimit dhe me diskriminim, veçanërisht ata që nuk kanë arritur të ruajnë identitetin e tyre kulturor dhe kombëtar. Po ashtu, brezat e dytë dhe të tretë të emigrantëve mund të përballen me rrezikun e asimilimit dhe humbjes së lidhjeve me vendlindjen, çka mund të ndikojë në lidhjet e tyre me Kosovën dhe zhvillimin e saj në të ardhmen”, tha ai. Megjithatë, kontributi i diasporës mbetet potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e Kosovës. Sipas profesorit Dana, diaspora mund të luajë një rol kyç në zhvillimin afatgjatë të Kosovës nëpërmjet investimeve strategjike, promovimit të teknologjive dhe trajnimit të fuqisë punëtore, si dhe në mbështetje të projekteve zhvillimore që përmirësojnë infrastrukturën dhe ndihmojnë në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm.

Kah fundi, rënia e popullsisë në Kosovë është një pasqyrë e thellë e sfidave dhe transformimeve që po kalon shoqëria kosovare. Për të përballuar sfidat e ardhshme, është e nevojshme që institucionet dhe shoqëria kosovare të mendojnë për një planifikim të mirëfilltë urban dhe ekonomik, që do të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh vendndodhjen e tyre.

Dionesa EBIBI

"Kur popullsia mbi 65 vjeç kalon 12% të popullsisë së përgjithshme, kjo tregon se vendi ka hyrë në fazën e një popullate të plakur, që ka pasojat e veta në zhvillimin afatgjatë"

të kujdesshëm dhe strategjik për të siguruar që sfidat të menaxhohen në mënyrë efektive, duke siguruar mbështetje të nevojshme për ata që kërkojnë kujdes shëndetësor dhe mbështetje sociale”, vlerëson ai.

‘Takati’ i Kosovës në pëllëmbë të diasporës kosovare...

sht i shtresës intelektuale dhe e shkolluar, ka lënë boshllëqe në disa sektorë kyç dhe ka ngadalësuar zhvillimin ekonomik në disa raste. Kjo ka sjellë një zvogëlim të mundësive për zhvillimin e industrive dhe sektorëve produktivë në Kosovë, për shkak të mungesës së punëtorëve të kualifikuar.

Shporta e shtrenjtë qytetarët k

Fjolla GASHI

Tash e disa vite, qytetarët e Kosovës po përballen me çmime gjithnjë e më të larta për produktet ushqimore. Kjo ka krijuar një barrë të madhe për shumë familje, të cilat po hasin vështirësi për të mbuluar nevojat e përditshme. Kjo situatë ka bërë që shumë qytetarë të kërkojnë alternativa më të lira për të përballuar jetesën, duke reduktuar shpenzimet për produkte të ndryshme, por kryesisht ushqimore.

E këto çmime të larta të produkteve kanë detyruar qytetarët e Kosovës gjatë muajit shkurt, të fillojnë një nismë të re të quajtur “Kosova bojkoton”, e cila ka marrë mbështetje të konsiderueshme. Ky aktivitet, i organizuar përmes rrjeteve sociale, ka ftuar qytetarët të bojkotojnë blerjet në supermarketet në ditët 10, 15 dhe 16 shkurt, në shenjë proteste kundër çmimeve të papërbalueshme. Nisma ka për qëllim të shprehë pakënaqësinë ndaj rritjes së vazhdueshme të çmimeve dhe të kërkojë uljen e tyre, duke shtuar presion ndaj autoriteteve dhe tregtarëve. Kjo nismë ka nisur fillimisht në Kroaci dhe ka rezultuar në një rënie prej më shumë se 50% të shitjeve në të gjithë vendin. Pas suksesit të saj, ajo është zgjeruar dhe është implementuar edhe në shtete të tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Për një vlerësim më të thellë të kësaj situatë, kemi intervistuar profesorin universitar në Fakultetin e Ekonomisë në UBT, Eral Lubishtani, i cili ndau mendimet dhe pikëpamjet e tij në lidhje me këtë zhvillim dhe pasojat e tij.

Cilat janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e çmimeve të produkteve

ushqimore në Kosovë?

“Rritja e çmimeve të produkteve ushqimore në Kosovë është një pasqyrë e një sërë faktorësh makroekonomik që kanë ndikuar në ekonomi. Në nivel global, inflacioni ka pasur një ndikim të ndjeshëm, i nxitur nga faktorë të jashtëm, si lufta në Ukrainë pandemia dhe problemet me zinxhirin e furnizimit që kanë çuar në rritjen e çmimeve të burimeve kryesore. Për më tepër, çmimet e karburanteve dhe transportit kanë pësuar një rritje të konsiderueshme, çka ka ndikuar direkt në kostot e furnizimit me produkte ushqimore. Gjithashtu, Kosova ka një varësi të lartë nga importet, gjë që e bën të ndjeshme ndaj çmimeve ndërkombëtare, duke e rritur më tej presionin për rritje të çmimeve. Një tjetër faktor që ka ndikuar është politikbërja e brendshme, përfshirë ngurtësinë e qeverisë për të mos ndryshuar taksat dhe tarifat e importit, të cilat gjithashtu kanë pasur ndikim në formimin e çmimeve për konsumatorët”.

Si shpjegohet që shumë shtete të Bashkimit Evropian kanë çmime më të ulëta për produktet ushqimore, edhe pse standardi i jetesës atje është më i lartë krahasuar me Kosovën?

“Ndryshe nga Kosova, shumë shtete të Bashkimit Evropian (BE) kanë çmime më të ulëta për produkte ushqimore, dhe një standard jetese më të lartë. Kjo mund të shpjegohet kryesisht nga dy faktorë kryesorë: mbështetja e fuqishme qeveritare për sektorin bujqësor dhe ekonomia



Prof. Dr. Eral LUBISHTANI

e shkallës. Shtetet anëtare të BE-së shpesh ofrojnë subvencione të konsiderueshme për bujqësinë, gjë që ndihmon në mbajtjen e kostove të prodhimit të ulëta. Për më tepër, këto shtete përfitojnë nga prodhimi masiv dhe efikasiteti i rritur në sektorin ushqimor, që u mundëson të sigurojnë produkte të përballueshme për konsumatorët, pavarësisht nivelit të lartë të jetesës. Një faktor tjetër është hapësira e madhe për tregti dhe marrëveshjet tregtare të favorshme dhe preferenciale që ndihmojnë në furnizimin me produkte me çmime konkurruese”.

Çfarë mendoni për nismën “Kosova bojkoton”. A mendoni se mund të ketë ndikim të dukshëm në uljen e çmimeve?



Bojkotet, xhepat e zbrazët, bojkotojnë!

“Iniciativa “Kosova Bojkoton”, e ngritur për të sensibilizuar dhe adresuar çmimet e larta, mund të ketë një ndikim të përkohshëm në treg, por nuk është e qartë nëse ajo mund të sjellë një ulje të qëndrueshme të çmimeve. Bojkoti mund të krijojë një presion të menjëhershëm mbi tregun, duke bërë ndërgjegjësimitin e konsumatorëve dhe tregtarëve për çështjet e çmimeve. Megjithatë, përpjekjet për të ulur çmimet nëpërmjet bojkotit mund të rezultojnë në një efekt të kufizuar, pasi mungesa e furnizimit mund të çojë në rritje të kërkesës duke ndikuar negativisht në stabilitetin e çmimeve”.

Si mund të ndikojnë bojkotet në tregun e brendshëm dhe a mund të shkaktojnë një efekt të kundërt duke rritur çmimet në vend se t'i ulin ato?

“Pavarësisht synimeve të bojkotit për të ulur çmimet, mund të ndodhin efekte të kundërta. Një bojkot masiv mund të krijojë një mungesë të produkteve në treg dhe të rrisë kërkesën për ato produkte që mbeten në dispozicion, duke çuar në një rritje të çmimeve. Për më tepër, bojkotet mund të dëmtojnë bizneset lokale, duke shkakuar humbje për prodhuesit dhe distributorët, të cilët mund të përpiqen të kompensojnë humbjet e shkaktuara duke rritur çmimet e produkteve të tjera”.

Si mund të ndërhyjë shteti për të zgjidhur këtë situatë, përveç që mund të mbështesë nisma të tilla. A ekzistojnë mekanizma të tjerë për të rregulluar çmimet e produkteve ushqimore?

“Shteti mund të luajë një rol të rëndësishëm në stabilizimin e tregut dhe uljen e çmimeve përmes politikave mbështetëse dhe rregullative. Mbështetja për prodhuesit e brendshëm përmes subvencioneve dhe investimeve në teknologji bujqësore mund të ndihmojë në rritjen e prodhimit vendas dhe zvogëlimin e varësisë nga importet. Po ashtu, shteti mund të ndërhyjë për të krijuar mekanizma rregullatorë që sigurojnë transparencën e çmimeve dhe parandalojnë praktikën e çmimeve abuzive. Këto masa do të mund të ndihmojnë në përmirësimin e konkurrencës dhe rregullimin e tregut në periudha afatgjata”.

Si e shihni të ardhmen e tregut të ushqimeve në Kosovë nëse ky trend i çmimeve të larta vazhdon. A shihni mundësi për stabilizim?

“Perspektivat për tregun e ushqimeve në Kosovë mbeten të ndërlikuara, por ka mundësi për stabilizim nëse zbatohet një qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit bujqësor. Investimet në teknologji dhe infrastrukturë, përfshirë për-

"Iniciativa "Kosova Bojkoton", e ngritur për të sensibilizuar dhe adresuar çmimet e larta, mund të ketë një ndikim të përkohshëm në treg, por nuk është e qartë nëse ajo mund të sjellë një ulje të qëndrueshme të çmimeve".

Prof. Dr. Ermal LUBISHTANI



mirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe menaxhimin e burimeve, mund të kontribuojnë në rritjen e prodhimit vendas dhe uljen e varësisë nga importet. Gjithashtu, rritja e efikasitetit në sektorin ushqimor dhe krijimi i marrëveshjeve tregtare të favorshme mund të ndihmojnë në stabilizimin e çmimeve dhe përmirësimin e konkurrencës. Në këtë mënyrë, Kosova mund të ketë mundësi për të stabilizuar çmimet dhe për të siguruar një treg më të qëndrueshëm dhe të përballeshëm për konsumatorët e saj”. Në mbarë botën, inflacioni ka marrë hov të madh, duke u shndërruar në një nga sfidat më të mëdha ekonomike të kohëve të fundit. E natyrisht, edhe shteti ynë, Kosova, nuk ka mbetur imun ndaj këtyre zhvillimeve. Si një ekonomi e vogël dhe e ndërlidhur me tregjet rajonale dhe globale, ajo është përballur me rritje të ndjesh-

me të çmimeve të produkteve bazë, veçanërisht të ushqimeve dhe karburanteve.

Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve, duke rënduar koston e jetesës dhe duke sfiduar stabilitetin ekonomik të vendit. Në këtë periudhë pasigurie ekonomike, mbetet jetike që institucionet të ndërmarrin hapa të qëndrueshëm për të lehtësuar barrën e qytetarëve dhe për të krijuar politika që sigurojnë një stabilitet afatgjatë.

Në këtë kohë sfidash, shpresa mbetet forca kryesore që i mban njerëzit në këmbë, ndërsa pritsmëritë për një stabilitet ekonomik mbeten më të larta se kurrë!



Ekosistemi i Kosovës në duar të teknologjive gjeohapësinore

"Kosova duhet të investojë në ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme digjitale, për ta bërë teknologjinë gjeohapësinore një mjet të fuqishëm në luftën kundër ndryshimeve klimatike".

Prof. Faruk Foniqi

Dita ditës kur ndikimet e ndryshimeve klimatike po shkaktojnë tronditje të mëdha në çdo cep të botës, Kosova nuk është imune nga pasojat shkatërruese që po mbajnë peshë në ekosistemet natyrore dhe gjithashtu në strukturat ekonomike e shoqërore. Ngrohja globale, thjesht e matshme përmes rritjes së temperaturave mesatare dhe shfaqjes së fenomeneve ekstreme si thatësira dhe reshje të pakontrolluara, ka ndikuar drejtpërdrejt në fushat më jetike

klimes në Kosovë dhe cilat janë fushat më të prekura nga këto ndryshime, profesori vlerëson se efektet e këtij fenomeni janë tashmë të dukshme dhe po ndikojnë në sektorë kyç të ekonomisë dhe mjedisit. Ai thotë se ndryshimet klimatike kanë sjellë rritje të temperaturave mesatare, çka ka ndikuar ndjeshëm në bujqësi, duke ulur prodhimtarinë dhe duke ndryshuar ciklet e të mbjellave. Po ashtu, profesori shprehet se fenomenet ekstreme, si thatësirat dhe përmbytjet, kanë krijuar sfida të mëdha për infrastrukturën dhe jetesën e komuniteteve.

"Në vitet e fundit, thatësirat e shpeshta dhe reshjet ekstreme kanë dëmtuar rëndë sektorin e bujqësisë duke rrezikuar të ardhurat e fermerëve dhe sigurinë ushqimore, ashtu edhe ekonominë e vendit", thekson profesori.

Përflitet se degradimi i tokës dhe shpyllëzimi po avancojnë me ritme të shpejta, duke e bërë edhe më të brishtë ekosistemin e Kosovës përballë ndryshimeve klimatike. Se cilët janë disa shembuj konkret të ndikimit të ndryshimeve klimatike në mjedisin dhe sektorët kryesorë të Kosovës, profesori vlerëson se këto ndryshime tashmë po e sfidojnë seriozisht stabilitetin ekonomik dhe ekologjik të vendit. Ai thotë se bujqësia është ndër fushat më të prekura, ku reduktimi i rendimentit dhe mungesa e ujit po e vështirësojnë ndjeshëm jetesën e fermerëve dhe sigurinë ushqimore. Në të njëjtën kohë, profesori Foniqi shprehet se biodiversiteti po pëson dëmtime të mëdha, pasi ndryshimi i klimës po shkatërron habitatet natyrore, duke rrezikuar zhdukjen e shumë specieve autoktone.

"Temperaturat e larta dhe kushtet e reja klimatike po ndikojnë drejtpërdrejt në përhapjen e sëmundjeve të lidhura me ngrohjen globale, duke vënë në rrezik shëndetin e popullatës, veçanërisht të grupeve më të ndjeshme, si fëmijët dhe të moshuarit", u shpreh ai.

Vlerësohet se, përballë këtyre sfidave Kosova duhet të veprojë me urgjencë, duke zbatuar politika të qëndrueshme mjedisore dhe duke investuar në teknologji të gjelbra, në mënyrë që të zbutë efektet e ndryshimeve klimatike dhe të garantojë



Prof. Faruk FONIQI

të zhvillimit të Kosovës: bujqësinë, biodiversitetin, dhe shëndetin publik.

Këto ndryshime po sfidojnë jo vetëm infrastrukturën dhe natyrën, por gjithashtu kërkojnë angazhim të menjëhershëm dhe strategji afatgjata për të ndihmuar komunitetin kosovar të përballojë pasojat e këtij fenomeni të paevitueshëm.

Në këtë kontekst të rëndësishëm, Faruk Foniqi, gjeograf dhe specialist në fushën e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe Remote Sensing, ndihmon për të ofruar një kuptim më të thellë të asaj se si këto ndryshime po ndikojnë në mjedisin dhe sektorët e ndryshëm të Kosovës. Foniqi shpërndan njohuri dhe shembuj konkret që tregojnë përmasat e kësaj krize ekologjike, si dhe për rolin jetik të teknologjive gjeohapësinore për një të ardhme më të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.

Në pyetjen se si po ndikon ndryshimi i

një të ardhme më të sigurt për qytetarët e saj.

Si mund të përdoren teknologjitë gjeohapësinore për të monitoruar dhe vlerësuar pasojat e ndryshimeve klimatike në Kosovë, profesori vlerëson se këto teknologji luajnë një rol thelbësor në analizën dhe parandalimin e fenomeneve klimatike ekstreme. Ai thotë se Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe sensorët në distancë mundësojnë mbledhjen e të dhënave në kohë reale, duke ndihmuar në monitorimin e ndryshimeve në përdorimin e tokës dhe mbulimin e pyjeve. Po ashtu, profesori shprehet se imazhet satelitore ndihmojnë në vlerësimin e përmbajtjeve dhe modelimin e thatësirave, duke i dhënë institucioneve mundësinë të hartojnë politika të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve natyrore.

“Përdorimi i teknologjisë gjeohapësinore ka mundësuar hartimin e zonave të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe krijimin e strategjive efektive për mbrojtjen e komuniteteve lokale”, thekson Foniqi, i cili tutje shton se përmes këtyre teknologjive, Kosova ka mundësi të rrisë kapacitetin e saj në parashikimin dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke krijuar një mjedis më të qëndrueshëm dhe më të mbrojtur ndaj krizave ekologjike.

Kur flitet për mundësitë dhe sfidat që ka Kosova në integrimin e teknologjive gjeohapësinore në strategjitë e saj për luftimin e pasojave të ndryshimeve klimatike, profesori vë në theks se vendi ka një potencial të madh për të përfutur nga këto teknologji, por përballat edhe me pengesa të konsiderueshme. Ai thotë se një nga mundësitë më të rëndësishme është bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, si ESA dhe NASA, për transferimin e njohurive dhe teknologjisë, duke lehtësuar kështu ndërtimin e kapaciteteve të brendshme. Po ashtu, qasja në të dhëna të hapura, si ato nga programi Copernicus, mund të ndihmojnë në monitorimin në kohë reale të fenomeneve klimatike dhe në marrjen e masave parandaluese.

“Kosova ka nevojë për një qasje më të organizuar dhe investime të qëndrueshme për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e teknologjive gjeohapësinore”, shprehet profesori Foniqi.

Gjithnjë duke ju referuar profesorit, sfidat kryesore përfshijnë koston e lartë të pajisjeve dhe softuerëve të specializuar, si dhe mungesën e ekspertëve të trajnuar për përdorimin

e këtyre teknologjive. E sipas tij, një tjetër pengesë është fragmentimi i të dhënave mjedisore dhe mungesa e një platforme të centralizuar, e cila do të mundësonte shkëmbimin e informacionit mes institucioneve relevante.

“Në këtë kontekst, Kosova duhet të investojë në ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme digjitale, për ta bërë teknologjinë gjeohapësinore një mjet të fuqishëm në luftën kundër ndryshimeve klimatike”, tha profesori.

Në temën se si të dhënat e mbledhura nga satelitët dhe sistemet GIS mund të ndihmojnë në parashikimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore të lidhura me ndryshimet klimatike në Kosovë, profesori i gjeoinformatikës, Foniqi, thekson rëndësinë e integritimit të teknologjisë në politikat mjedisore dhe strategjitë e menaxhimit të rreziqeve.

Sipas tij, përdorimi i imazheve satelitore dhe analizave të avancuara gjeohapësinore ka mundësuar identifikimin e zonave të rrezikuara nga përmbajtjet dhe rrëshqitjet e dheut, veçanërisht në rajonet malore të Kosovës. “Falë sistemeve GIS dhe të dhënave satelitore, ne kemi mundësi të parashikojmë ndikimet e reshjeve intensive dhe të përcaktojmë masat që duhen ndërmarrë për të mbrojtur komunitetet lokale”, shpjegon profesori Foniqi.

Përveç kësaj, ai thekson se këto teknologji po përdoren gjithnjë e më shumë për të monitoruar ndryshimet në mbulesën bimore dhe përdorimin e tokës, çka ndihmon në identifikimin e thatësirave dhe hartimin e strategjive për menaxhimin e burimeve ujore. “Në një kohë kur ndryshimet klimatike po bëhen


"Kosova ka nevojë për një qasje më të organizuar dhe investime të qëndrueshme për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e teknologjive gjeohapësinore"

g gjithnjë e më të ndjeshme, është thelbësore që institucionet të investojnë në platformat e të dhënave të hapura dhe në krijimin e një infrastrukture të integruar të informacionit mjedisor”, thotë ai.

Sipas ekspertëve, integrimi i teknologjive gjeohapësinore në Kosovë mbetet ende sfidë për shkak të kostove të larta dhe mungesës së një databaze të centralizuar. Megjithatë, profesor Foniqi thekson se me bas-

Number of days with 'strong heat stress' in summer 2024

A day with 'strong heat stress' has a maximum feels-like temperature (UTCI) exceeding 32°C



PROGRAMME OF THE EUROPEAN UNION Copernicus IMPLEMENTED BY ECMWF Climate Change Service

hkëpunimin e duhur mes institucioneve akademike, qeveritare dhe sektorit privat, vendi mund të përfitojë nga përparësitë e këtyre teknologjive për të përmirësuar menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe për të siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm.

Kur profesori Foniqi ndalet në pyetjen se si mund të përmirësohet infrastrukture e të dhënave dhe kapacitetet teknologjike në Kosovë për monitorimin dhe menaxhimin e ndryshimeve klimatike në një periudhë afatgjatë, ai vlerëson se “përmirësimi i infrastrukturës së të dhënave dhe kapaciteteve teknologjike mund të arrihet përmes një qasjeje të integruar që përfshin investime, bashkëpunim ndërinstytucional dhe zhvillim të fuqisë punëtore”.

Ai argumenton se “krijimi i një platforme të centralizuar për të dhënat


htë po ashtu thelbësor. Trajnimet dhe programet arsimore në fushën e teknologjive gjeohapësinore, në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet ndërkombëtare, janë të domosdoshme për “krijimin e një grupi të kualifikuar ekspertësh vendas”. Ai thekson se “përfshirja e sektorit privat dhe startupeve teknologjike në zhvillimin e zgjidhjeve digjitale për menaxhimin e klimës mund të sjellë risi dhe qasje të reja”.

Për më tepër, profesori sugjeron se, angazhimi në programe ndërkombëtare si Copernicus, Galileo ose projekti ESA për monitorimin e tokës do të mundësonte qasje në të dhëna të sofistikuar satelitore dhe burime financiare për zhvillimin e infrastrukturës teknologjike. Ai vlerëson gjithashtu rëndësinë e forcimit të legjislacionit dhe krijimit të politikave të qarta për menaxhimin e të dhënave mjedisore, duke shtuar se këto masa “do të siguronin qëndrueshmëri institucionale dhe funksionim të qëndrueshëm të sistemeve të monitorimit”.

Duke përfunduar fjalën dhe jo diskutimin mbi temën që kërkon trajtim të vazhdueshëm, profesori Foniqi thotë se duke shfrytëzuar avancimin e teknologjive gjeohapësinore dhe angazhimin institucionale të koordinuar, Kosova ka mundësinë të përballojë sfidat e ndryshimeve klimatike dhe të krijojë një të ardhme më të qëndrueshme për brezat që vijnë.

Dionesa EBIBI

Zgjedhjet e 9 shkurtit: Si ndryshimi i ri ballafaqohet me procesin zgjedhor?



Më 9 shkurt, Kosova mbajti zgjedhjet parlamentare, dhe që nga zgjedhjet e fundit të vitit 2021, disa aspekte të procesit të votimit kanë pësuar ndryshime. Ndryshimi kryesor krahasuar me zgjedhjet e kaluara është mundësia që votuesit të zgjedhin deri në 10 kandidatë nga një parti e caktuar.

Ky ndryshim, megjithatë, shihet si një mundësi për kandidatët më pak të njohur që të integrohen në arenën politike të Kosovës. Nga ana tjetër, modifikimi i fundit i procedurave zgjedhore ka sjellë gjithashtu një çështje logjistike, duke krijuar ngarkesë në qendrat e numërimit dhe duke hapur mundësinë për ndasi brenda partive politike.

Veton Zejnullahu, profesor i Shkencave Politike në UBT, këtë ndryshim në zgjedhjet e 9 shkurtit e sheh si një luftë që do të zhvillohet për mbështetje nga votuesit tradicional të subjekteve politike.

Si e vlerësoni ndryshimin në zgjedhjet e fundit, duke rritur numrin e kandidatëve nga 5 në 10, dhe cilat janë ndikimet e tij mbi procesin zgjedhor?

“Shtimin e numrit të kandidatëve unë e shoh si një mundësi për kandidatët që nuk janë shumë të njohur për elektoratin, të garojnë dhe të kërkojnë shansin e tyre në tregun politik të Kosovës. Përveç të tjerave, rritja e numrit nga 5 në 10 është edhe ngarkesë për qendrat e numërimit. Unë mendoj se kjo rritje ka ndikim negativ edhe brenda subjekteve, sepse kandidatët do të fillojnë “luftën brenda llojit” për marrjen e votave dhe nuk do të koncentrohen në përvetësimin e votuesve të rinj dhe atyre të pavendosur, sepse e tërë “lufta” do të bëhet për votuesit tradicionalë të subjektit. Kjo i dëmton edhe kandidatët, edhe subjektin, sepse lë shumë terren të pambulluar, i cili do të shfrytëzohet nga subjektet tjera”.

Si ndikon rritja e numrit të kandidatëve nga 5 në 10 në besimin e publikut në këto zgjedhje?

“Ky ndryshim nuk e rrit besimin e publikut, sepse mundësia për manipulim është më e madhe, por e rrit mundësinë e përzgjedhjes nga qytetarët, sepse ata kanë mundësinë që nga 110 të përzgjedhin 10 kandidatë për t'i votuar. Rritja e numrit nga 5

në 10 është ngarkesë dhe shkakton edhe konfuzion për qytetarët, sepse ata duhet të mbajnë mend 10 numra, dhe ky fakt shumë më shpesh i favorizon kandidatët për deputetë që janë nga numri 1-10 në listat votuese. Thuhet që çdo votues i ka 4-5 kandidatë të preferuar dhe pastaj pjesën tjetër, për të mos lënë fletëvotimin jo të plotë, i zgjedh shpejt nga 10 të parët”.

Si mund të shfrytëzojnë partitë politike dhe grupet e interesit ndryshimet në procesin zgjedhor, duke përfshirë rritjen e numrit të kandidatëve, për të ndikuar në rezultatet zgjedhore?

“Përpilimi i listave favorizuese nga partitë politike për kandidatët e

preferuar dhe koncentrimi i fortë i votës në baza rajonale e rrit shansin e grupeve të interesit që të kenë përfaqësuesit e tyre në Kuvend, por njëkohësisht i dëmton partitë politike, sepse nga karakteri kombëtar kthehen në karakter rajonal, duke i votuar përfaqësuesit vetëm të rajonit të tyre. Ky fakt dërgon një mesazh te votuesit, aktivistët dhe kandidatët potencial nga rajonet e tjera që mos t'i hyjnë garës zgjedhore – fenomen ky shumë aktual në këto zgjedhje. Një tjetër fakt është edhe rasti i manipulimit me votën brenda subjektit, ku votat tregtohen duke ua marrë atyre që nuk kanë numërues te tyre (mos e harroni procesin e kaluar kur numëruesit janë dënuar edhe me burg), dhe duke ua shtuar kandidatëve të tjerë, duke ndikuar kështu edhe në rezultatin e brendshëm të listës së subjektit, sidomos nëse numrimi bëhet me dorë. Pavarësisht faktit që ligji thotë që çdo votë do të skanohet, nuk po shohim ndryshim pozitiv, sidomos pas bllokimit të tërë sistemit të KQZ-së, ku për shumë orë nuk kishte informata zyrtare rreth rezultateve”.

Rezultatet e zhvilluara deri më sot nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) tregojnë se Lëvizja Vetëvendosje po udhëheq në zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit, megjithatë, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021, ka shënuar një rënie në mbështetje. Ndërkohë, sipas rezultateve preliminare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë shënuar rritje të votave.


Si pasojë e problemeve të shumta teknike në procesin e numërimit të votave nga KQZ, komisioni ka vonuar publikimin e rezultateve preliminare.

Dea BERISHA

"Rritja e numrit nga 5 në 10 është ngarkesë dhe shkakton edhe konfuzion për qytetarët sepse duhet të mbajnë mend 10 numra dhe ky fakt shumë më shpesh i favorizon kandidatët për deputetë që janë nga numri 1-10 në listat votuese".

Prof. Ass. Dr.Veton ZEJNULLAHU

Ndotja e ajrit: Pasojat shëndetësore, burimet dhe zgjidhjet për përmirësimin e cilësisë



Ndotja e ajrit është një nga sfidat kryesore mjedisore dhe shëndetësore në botë, e shkaktuar nga faktorë natyrorë dhe antropogjenë. Rritja e industrializimit, urbanizimit dhe aktiviteteve njerëzore ka ndikuar ndjeshëm në cilësinë e ajrit, duke pasur pasoja serioze për shëndetin dhe ekosistemet. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), mbi 90% e popullsisë botërore jeton në zona ku ndotja e ajrit tejkalon nivelet e rekomanduara. Ndotja e ajrit është veçanërisht e theksuar në qytetet e industrializuara, ku emetimet nga automjetet, fabrikat dhe proceset bujqësore rrisin ndjeshëm ekspozimin ndaj ndotësve atmosferikë.

Ndotja e ajrit vjen nga burime natyrore si shpërthimet vullkanike, zjarret në pyje dhe stuhitë e pluhurit, por pjesa më e madhe e saj shkaktohet nga aktiviteti njerëzor. Djegia e karburanteve fosile në industri dhe transport gjeneron ndotës si dioksidi i azotit (NO₂), monoksidi i karbonit (CO) dhe grimcat e imëta PM_{2.5} dhe PM₁₀. Aktivitetet bujqësore gjithashtu kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit, pasi përdorimi i plehrave kimike dhe pesticidëve çliron amoniak dhe komponime organike të paqëndrueshme (VOCs).

Indeksi i Cilësisë së Ajrit (AQI) është një tregues i standardizuar për matjen e cilësisë së ajrit dhe ndikimit të tij

"Cilësia e ajrit është thelbësore për shëndetin publik, dhe përmirësimi i saj kërkon një angazhim të përbashkët nga qeveritë, organizatat mjedisore dhe qytetarët"

Halil PONIK

në shëndet. AQI kategorizon ndotjen nga "mirë" deri në "i rrezikshëm", duke informuar publikun mbi masat mbrojtëse që duhet të marrin. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka vendosur kufij specifikë për ndotësit kryesorë të ajrit dhe ndikimin e tyre në popullatë. Në shumicën e rasteve, nivelet e AQI mbi 150 konsiderohen të pashëndetshme për popullsinë, ndërsa vlerat mbi 300 përfaqësojnë rrezik serioz për të gjithë individët, veçanërisht ata me sëmundje kronike.

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj ndotjes së ajrit lidhet me sëmundje kronike si astma, sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri i mushkërive. Grimcat e vogla PM_{2.5} depërtojnë thellë në mushkëri dhe mund të hyjnë në qarkullimin e gjakut, duke shkaktuar inflamacion dhe rritje të rrezikut për sëmundje të zemrës. Gjithashtu, ndotja e ajrit ndikon në ndryshimet klimatike duke rritur efektin serë dhe temperaturat globale. Një aspekt tjetër kritik është ndikimi i ndotjes së ajrit në biodiversitet, pasi ndotësit atmosferikë mund

të dëmtojnë bimësinë dhe të shkaktojnë ndryshime në ekosisteme të ndjeshme.

Teknologjitë moderne, si sensorët optikë, pajisjet elektro-kimike dhe sistemet satelitore, ofrojnë matje të sakta të ndotjes së ajrit. Stacionet fikse dhe pajisjet portative ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave dhe interpretimin e tyre për vendimmarrje mjedisore. Dronët me sensorë të integruar po përdoren gjithnjë e më shumë për të matur ndotjen në zona të vështira për t'u monitoruar nga toka.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit kërkon masa të forta, si përdorimi i burimeve të pastra të energjisë, zbatimi i legjislacionit mjedisor dhe përmirësimi i transportit publik. Përdorimi i teknologjive të avancuara, si Intelligjenca Artificiale dhe Interneti i Gjerave (IoT), mundëson analizë të thelluar të të dhënave dhe krijimin e strategjive efektive për uljen e ndotjes. Shtimi i hapësirave të gjelbra dhe mbjellja e pemëve në qytete janë gjithashtu hapa të rëndësishëm për

të reduktuar përqendrimin e ndotësve në atmosferë.

Menaxhimi i ndotjes së ajrit është jetik për ruajtjen e shëndetit publik dhe ekosistemeve. Kombinimi i teknologjive të avancuara, analizave shkencore dhe politikave mjedisore mundëson krijimin e strategjive efektive për reduktimin e ndotjes dhe ruajtjen e cilësisë së ajrit. Një përpjekje e vazhdueshme nga qeveritë, organizatat mjedisore dhe qytetarët është thelbësore për të adresuar këtë sfidë globale dhe për të krijuar një mjedis më të shëndetshëm për brezat e ardhshëm.

Halil PONIK

Remote Sensing: Rritja e efikasitetit në menaxhimin e mjedisit dhe infrastrukturës në Kosovë




Prof. Ass. Dr. Edon Maliqi

Në një periudhë kohore ku ndryshimet globale po ndodhin me shpejtësi të jashtëzakonshme, teknologjitë moderne luajnë një rol të pashmangshëm në monitorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore, zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe parashikimin e fatkeqësive natyrore. Një nga teknologjitë më të avancuara në këtë fushë është Remote Sensing, e cila ka gjetur përdorim të gjerë në shumë disiplina të ndryshme shkencore. Për të kuptuar më mirë rëndësinë dhe aplikimet e saj, Edon Maliqi, profesor në fushën e gjeoinformatikës dhe hartografisë, ofroi një pasqyrë të detajuar mbi këtë teknologji dhe përdorimet e saj praktike.

Në përgjigje të pyetjes se çfarë është Remote Sensing dhe si funksionon, profesori Maliqi e shpjegon këtë teknologji si një fushë të shkencës dhe artit të mbledhjes së informacionit për një objekt ose fenomen, pa pasur nevojë për kontakt fizik me të. Ky proces realizohet përmes përdorimit të rrezatimit elektromagnetik që emetohet ose reflektohet nga objekti që po studiohet. "Instrumentet e specializuara, si sensorët të mbartur nga satelitët apo avionët, mundësojnë mbledhjen e të dhënave nga distanca, të cilat më pas analizohen dhe interpretohen për të siguruar njohuri të thella mbi sipërfaqen e Tokës dhe fenomenet që ndodhin në të", shpjegon ai. Profesori Maliqi thekson se një nga avantazhet kryesore të kësaj teknologjie është aftësia për të mbledhur të dhëna të sakta dhe të detajuara, pa pasur nevojë për afrim fizik në zonat e interesit.

"Kjo teknologji ofron një gamë të gjerë të dhënash, përfshirë fotografite ajrore të realizuara nga avionët, të cilat përdoren për hartimin dhe analizën e përdorimit të tokës, imazhet satelitore që ofrojnë mbulim të gjerë të territoreve, si dhe të dhënat radar, të cilat janë të rëndësishme për parashikimin e motit dhe analizën e terrenit. Po ashtu, përdorimi i teknologjisë LiDAR për matjen e distancave dhe krijimin e modeleve 3D të terrenit është një tjetër aplikim i rëndësishëm, që kontribuon në përmirësimin e analizave të mjedisit dhe zhvillimeve urbane"

Prof. Ass. Dr. Edon Maliqi





"Kjo teknologji ofron një gamë të gjerë të dhënash, përfshirë fotografite ajrore të realizuara nga avionët, të cilat përdoren për hartimin dhe analizën e përdorimit të tokës, imazhet satelitore që ofrojnë mbulim të gjerë të territoreve, si dhe të dhënat radar, të cilat janë të rëndësishme për parashikimin e motit dhe analizën e terrenit. Po ashtu, përdorimi i teknologjisë LiDAR për matjen e distancave dhe krijimin e modeleve 3D të terrenit është një tjetër aplikim i rëndësishëm, që kontribuon në përmirësimin e analizave të mjedisit dhe zhvillimeve urbane", vlerëson profesori Maliqi.

Një nga proceset kyçe të teknologjisë Remote Sensing është klasifikimi i imazheve satelitore, një metodë që përfshin ndarjen e pikselëve të imazhit në kategori kuptimplotë, bazuar në karakteristikat e tyre spektrale. Siç thekson profesori Maliqi, ky proces ndihmon në organizimin dhe kategorizimin e të dhënave për aplikime të ndryshme. "Për shembull, një piksel mund të identifikohet si pyll, ujë, zonë urbane, etj., çka lehtëson analizën e mëtejshme dhe përdorimin e të dhënave për qëllime specifike". Klasifikimi mund të realizohet në formë të ndryshme, si klasifikimi i mbikëqyrtur, i pambikëqyrtur ose i bazuar në objekte, secila me-

todë kërkon qasje dhe teknika të ndryshme për analizën e të dhënave.

Remote Sensing ofron një spektër të gjerë aplikacionesh në fusha të ndryshme, duke mbuluar aspekte të shumta të jetës, nga monitorimi i mjedisit deri te zhvillimi i infrastrukturës urbane. Profesori Maliqi nënvizon se kjo teknologji ka ndikim të madh në sektorë kyç, përfshirë identifikimin dhe hartimin e mbulesës së tokës, si pyjet, bujqësia, zonat urbane dhe trupat ujorë. Ajo gjithashtu është thelbësore për monitorimin e mjedisit, duke përfshirë ndotjen, shpyllëzimin dhe fatkeqësitë natyrore si përmbytjet dhe thatësitrat. Në sektorin e bujqësisë, Remote Sensing ndihmon në vlerësimin e shëndetit të të korrave dhe monitorimin e sëmundjeve të bimëve, ndërsa në planifikimin urban, është e rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës dhe analizën e modeleve të rritjes urbane. Po ashtu, kjo teknologji luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e fatkeqësive, vlerësimin e dëmeve dhe mbështetje për operacionet e shpëtimit. Aplikime të tjera të saj përfshijnë fushat e gjeologjisë dhe minierave, duke ndihmuar në eksplorimin e burimeve minerale dhe monitorimin e aktiviteteve minerare, si dhe përdorimin në fushën ushtarake, për mbikëqyrje dhe mbledhjen e informacionit.



Profesor Edon Maliqi, profesionist i teknologjive të Remote Sensing, theksoi disa çështje etike të rëndësishme që duhen marrë parasysh gjatë përdorimit të kësaj teknologjie. Siç shpjegon ai, një ndër shqetësimet kryesore lidhet me privatësinë, pasi imazhet me rezolucion të lartë mund të zbulojnë informacion të ndjeshëm për individë ose aktivitete të tyre, duke ngritur pyetje për mbrojtjen e të drejtave personale. Profesori gjithashtu theksoi nevojën për diskutim rreth pronësisë dhe qasjes në të dhëna, duke u pyetur se kush i zotëron dhe kontrollon ato dhe si mund të përdoren ato në mënyrë të përgjegjshme.

Një tjetër shqetësim që profesori ngriti është mundësia e keqpërdorimit të të dhënave, ku informacione të tilla mund të përdoren për mbikëqyrje të paligjshme, qëllime ushtarake ose për përhapjen e dezinformatave. Për më tepër, ai theksoi ndikimin mjedisor, duke përmendur pasojat që mund të kenë lëshimi dhe asgjësimi i satelitëve, të cilat mund të ndikojnë negativisht në ekosistemet dhe mjedisin rrethues. Gjatë intervistës, profesori Maliqi theksoi gjithashtu rëndësinë e Remote Sensing për adresimin e sfidave mjedisore. Ai shprehu pasionin për mundësitë që kjo teknologji ofron në monitorimin e zhvillimit të qyteteve, shpyllëzimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujit, duke shpresuar që këto mundësi të kontribuojnë në zgjidhje inovative për një

planet më të shëndetshëm. Profesori beson se rinia shqiptare ka mundësinë të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në këtë fushë, duke përdorur Remote Sensing për të analizuar dhe vlerësuar ekosistemet, si dhe për të mbështetur praktikatat e qëndrueshme bujqësore dhe zhvillimin urban.

Në përgjigje të pyetjes mbi arsyet e zgjedhjes së kësaj fushe të studimit, profesori Maliqi theksoi se Remote Sensing ka fuqinë të ofrojë njohuri të thella mbi planetin tonë dhe të ndihmojë në zgjidhjen e problematikave globale si ndryshimi i klimës dhe menaxhimi i burimeve natyrore. Ai jep shpresë se puna e tij do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve mjedisore dhe sociale, si në Kosovë ashtu edhe më gjerë.

Në lidhje me përdorimin e Remote Sensing për monitorimin e mjedisit, profesori theksoi se kjo teknologji është esenciale për vlerësimin e ndryshimeve të mbulesës së tokës, monitorimin e ndotjes dhe ndryshimeve klimatike, si dhe për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Ai përmendi gjithashtu se Remote Sensing është i domosdoshëm për menaxhimin e fatkeqësive natyrore, duke siguruar informacion të shpejtë dhe të saktë mbi dëmet, ndihmën e nevojshme dhe rikuperimin pas katastrofave.

Një tjetër sfidë që profesori theksoi lidhet me përdorimin e Remote Sensing për planifikimin urban,

ku mjediset urbane të heterogjenizuara bëjnë analizën dhe interpretimin e të dhënave më të ndërlikuara. Ai nënvizoi rëndësinë e një rezolucioni të mjaftueshëm të të dhënave dhe vështirësitë e interpretimit të saktë të imazheve, sidomos në qytetet në zhvillim.

Maliqi gjithashtu theksoi ndikimin e madh të Remote Sensing në fushën e “precision agriculture”, ku përdorimi i sensorëve për monitorimin e shëndetit të të korrave, menaxhimin e ujit dhe optimizimin e përdorimit të plehrave është thelbësor për rritjen e produktivitetit dhe kursimin e burimeve.

Në përfundim, profesori Maliqi theksoi se Remote Sensing përfaqëson një teknologji të avancuar, e cila ka potencialin për të kontribuar në krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe të menaxhuar me efikasitet, si në nivel global, ashtu edhe në atë lokal, veçanërisht në Kosovë. Ai theksoi rëndësinë e kësaj fushe si një mundësi të shkëlqyer për rininë shqiptare, duke ofruar mundësinë për t'u angazhuar në adresimin e sfidave mjedisore dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kosova në korridorin e 'Energjisë së Rinovueshme'

Dionesa EBIBI

Kur kriza energjetike dhe kërkesat për zhvillim të qëndrueshëm janë bërë gjithnjë e më të pranishme në diskursin global, Kosova ka një mundësi të jashtëzakonshme për t'u transformuar përmes përdorimit të energjisë së rinovueshme. Burimet e pasura diellore, të erës dhe biomasës janë pasuri të padiskutueshme që, nëse shfrytëzohen me mençuri, mund të krijojnë një të ardhme të qëndrueshme për vendin. Kjo mundësi nuk është vetëm një hap për t'u ndarë nga varësia nga energjia e importuar, por dhe për të nxitur zhvillimin e një industrie të re, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët.

Në temën mbi 'energjinë e rinovueshme dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë', Prof. Asoc. Dr. Besa Veseli, profesioniste në fushën e energjisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, thekson se energjia e rinovueshme nuk është thjesht një alternativë, por një domosdoshmëri për Kosovën.

"Ne kemi potencial të jashtëzakonshëm për të zhvilluar energjinë e pastër dhe për të krijuar një ekonomi të qëndrueshme. Përtej reduktimit të ndotjes, kjo mund të jetë një shtysë e madhe për zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të punës dhe tërheqjen e investimeve të huaja", shprehet ajo.

"Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për të zhvilluar energjinë e pastër dhe për të krijuar një ekonomi të qëndrueshme. Përtej reduktimit të ndotjes, kjo mund të jetë një shtysë e madhe për zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të punës dhe tërheqjen e investimeve të huaja".

Besa Veseli

Sipas saj, ndërtimi i parqeve diellore dhe të erës mund të krijojë mijëra vende të reja pune, që nga instalimi dhe mirëmbajtja e paneleve solare e deri te zhvillimi i teknologjive inovative për ruajtjen e energjisë. "Nëse investojmë në industrinë vendore të prodhimit të pajisjeve për energji të rinovueshme, mund të zvogëlojmë importet dhe të krijojmë një zinxhir të qëndrueshëm ekonomik", shton Veseli.

Një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi është Gjeoportali i Kosovës, i

cili tashmë përfshin një komponent të ri për energjinë solare dhe të erës. Ky mjet ofron të dhëna të detajuara mbi potencialin e rajoneve të ndryshme për zhvillimin e projekteve të energjisë së pastër. "Investitorët dhe politikat e këbërësit tani kanë mundësi të bazojnë vendimet e tyre në të dhëna konkrete, duke e bërë më të lehtë identifikimin e lokacioneve strategjike për energjinë e rinovueshme", shpjegon profesoresha.

Sipas saj, një shembull suksesi në këtë drejtim është kompania vendase Jaha Solar, e cila ka realizuar projekte të rëndësishme në Kosovë dhe rajon, duke përfshirë instalimin e sistemeve solare deri në 3 MWp në Kamenicë dhe mbi 100 çati industriale në Ballkan. "Modele të tilla tregojnë se Kosova ka kapacitete për të qenë një lider rajonal në energjinë e pastër", vlerëson Veseli. Megjithatë, sfidat mbeten të mëdha. Investimet fillestare për energjinë e rinovueshme janë të larta dhe infrastruktura aktuale energjetike ka ende nevojë për modernizim. Dhe sipas saj, për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, duhet një strategji e qartë kombëtare, mbështetje nga qeveria dhe politika stimuluese për investitorët privat.

Përveç përfitimeve ekonomike, kalimi në energji të pastër do të ndihmojë edhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, duke ulur ndotjen nga ter-

mocentralet me qymyr. "Për çdo hap që hedhim drejt energjisë së pastër, ne nuk po investojmë vetëm në ekonomi, por edhe në shëndetin e qytetarëve tanë dhe në të ardhmen e vendit", argumenton Veseli.

Duke ju referuar profesoreshës, me potencialin e madh që ka Kosova në këtë sektor dhe me investime të drejtuara mirë, energjia e rinovueshme mund të jetë jo vetëm zgjidhja për kri- zën energjetike, por edhe një katalizator për zhvillim të qëndrueshëm dhe përfshirje të vendit në tregjet ndër-

kombëtare të energjisë së pastër.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e energjisë diellore dhe të erës, por për ta shfrytëzuar këtë mundësi, nevojiten investime strategjike dhe reforma në sektorin energjetik. Profesoresha Veseli argumenton se shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme do të rriste prodhimin dhe sigurinë e energjisë, duke e bërë Kosovën më pak të varur nga qymyri dhe më konkurruese në rajon.

"Kosova ka mbi 2,000 orë me diell në vit, një faktor kyç për zhvillimin e energjisë diellore. Nëse realizohen investime të duhura, kapaciteti i prodhimit mund të arrijë deri në 1 GW", vlerëson ajo dhe se vendosja e paneleve në objekte publike, banesa dhe industri do të ndihmonte në rritjen e vetë-furnizimit me energji.

Ndërkaq, energjia e erës gjithashtu përfaqëson një mundësi të rëndësishme për Kosovën. "Rajone si Bajgora, Malësia e Pejës dhe Malet e Sharrit kanë erëra të favorshme me shpejtësi mesatare 5-7 m/s, duke krijuar kushte për projekte të mëdha me kapacitet deri në 500 MW", thekson Veseli.

Profesoresha thekson se për të rritur prodhimin dhe sigurinë energjetike, Kosova duhet të zbatojë politika mbështetëse dhe të investojë në një infrastrukturë moderne. Ajo sugjeron që subvencionet dhe lehtësirat fiskale për investitorët janë thelbësore për të përsheptuar kalimin në energji të pastër. Ajo identifikon disa masa kyçe për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, si liberalizimi i tregut të energjisë, modernizimi i rrjetit elektrik, zhvillimi i sistemeve të ruajtjes së energjisë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për financime dhe transferim teknologjie, që do të ndihmonin në sigurimin e një furnizimi energjetik të qëndrueshëm.

A është Kosova gati për këtë transformim?

A është Kosova e gatshme për këtë transformim të thellë dhe esencial, që kërkon jo vetëm ndryshim teknologjik, por edhe një transformim të thellë filozofik dhe kulturor? Në një periudhë ku energjia e rinovueshme nuk është më një luks, por një domos-



Prof. Ass. Dr. Besa VESELI

doshmëri për ruajtjen e botës dhe zhvillimin e qëndrueshëm, Kosova ndodhet përballë një dileme ekzistenciale. Sidoqoftë, edhe pse ka bërë hapa në drejtim të energjisë së pastër, profesoresha Veseli nënvizon se ky proces është ngadalësuar nga pengesat e thella burokratike dhe infrastrukturore.

Për ta përballuar këtë krizë, Veseli thotë se pa një vizion të qartë dhe një angazhim të thellë institucional, Kosova mund të mbetet prapa, si një shoqëri që e ka humbur kuptimin e transformimit të nevojshëm.

Për këtë, qeveria duhet të veprojë si një udhëheqëse e ndryshimit, duke hartuar një plan të qëndrueshëm dhe afatgjatë për kalimin në një sistem energjetik të pastër. Ky plan, sipas saj, duhet të përfshijë masat konkrete për të eliminimin gradual të termocentraleve të dëmshme dhe për të integruar burimet e pastra në rrjetin energjetik, të cilat nuk janë thjesht një mjet për të prodhuar energji, por një mundësi për të ripërtërirë lidhjen tonë me natyrën dhe për të rigjallëruar një filozofi të jetës që është në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

Nëse Kosova vepron tani, ajo mund të pozicionohet si një lider rajonal në energjinë e gjelbër. Por pyetja kryesore mbetet e njëjtë: A do të marrë vendi masa të guximshme për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme, apo do të vazhdojë të mbështe-

tet tek burimet tradicionale?

Rruga e zhvillimit, infrastruktura për energjinë e rinovueshme në Kosovë...

Në përgjigje të pyetjes se si mund të zhvillohet një infrastrukturë e qëndrueshme për ruajtjen dhe shpërndarjen e energjisë së rinovueshme në Kosovë, profesoresha mendon se ky proces kërkon një strategji të integruar që kombinon investimet në teknologji moderne, modernizimin e rrjetit energjetik dhe krijimin e politikave mbështetëse.

Ajo, ndër të tjerash, u ndal në rëndësinë e zhvillimit të teknologjive për ruajtjen e energjisë, duke theksuar se “një nga sfidat kryesore të energjisë së rinovueshme është se ajo nuk prodhohet në mënyrë të vazhdueshme”. Prandaj, sipas saj, Kosova duhet të fokusohet në bateritë e avancuara, hidrogjenin e gjelbër dhe sistemet e pompimit të ujit si zgjidhje për ruajtjen afatgjatë të energjisë.

Tutje, profesoresha Veseli vlerësoi se modernizimi i rrjetit të shpërndarjes është po aq i rëndësishëm sa dhe ruajtja e energjisë: “Nevojitet krijimi i rrjeteve inteligjente (smart grids) për të optimizuar shpërndarjen e energjisë dhe për të balancuar ngarkesën në mënyrë efikase”.

Për më tepër, u argumentua se zgjerimi dhe forcimi i rrjetit elektrik do të ndihmonte në integrimin e burimeve të rinovueshme, ndërsa mikro-rrjetet mund të sigurojnë një furnizim më të qëndrueshëm në nivel komunitar.

Duke folur për aspektin rregullator, ajo shtoi se “pa një kuadër ligjor dhe rregullator të mirëpërcaktuar, nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës energjetike”. Sipas saj, Kosova duhet të ofrojë subvencione për investimet në ruajtjen e energjisë, të rrisë fleksibilitetin e tregut duke lejuar prodhuesit e vegjël të shesin energjinë e ruajtur dhe të hartojë strategji afatgjata për tranzicionin energjetik.

Veseli argumenton se zhvillimi i një infrastrukture të qëndrueshme për ruajtjen dhe shpërndarjen e energjisë së rinovueshme në Kosovë është i mundur vetëm përmes një kombinimi të investimeve teknologjike, reformave rregullatore dhe modernizimit të rrjetit, duke krijuar kështu një bazë të fortë për tranzicionin drejt energjisë

së pastër.

Kur ndalet te pyetja se si mund të ndikojë energjia e rinovueshme në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe uljen e ndotjes mjedisore në Kosovë, profesoresha thotë se përdorimi i energjisë së pastër është një nga hapat më të rëndësishëm për të reduktuar ndotjen dhe për të mbrojtur shëndetin publik.

Tutje shton se, “Kosova përballet me një nga nivelet më të larta të ndotjes së ajrit në Evropë, kryesisht për shkak të varësisë nga qymyri për prodhimin e energjisë elektrike”. Sipas saj, termocentralet si “Kosova A” dhe “Kosova B” janë burime kryesore të ndotjes, duke emetuar grimca të rrezikshme për shëndetin, përfshirë PM2.5, PM10 dhe dioksid sulfuri (SO₂). Përflitet se tranzicioni drejt burimeve të pastra, si dielli dhe era, mund të ulë ndjeshëm emetimet ndotëse. “Mbyllja graduale e termocentraleve të vjetruara dhe investimi në energji të rinovueshme do të zvogëlojë ndotjen e ajrit dhe do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës së qytetarëve”, vlerëson ajo.

Duke cituar Organizatën Botërore të Shëndetësisë, ajo shton se ndotja e ajrit është një nga shkaqet kryesore të sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare në Kosovë. “Me reduktimin e ndotjes nga qymyri, rastet e astmës, bronkitit dhe sëmundjeve të mushkërive do të ulen ndjeshëm, duke përmirësuar mirëqenien e popullatës”, shpjegon ajo.

Tutje, profesoresha Veseli përmend edhe ndikimin e energjisë së pastër në reduktimin e ndotjes së tokës dhe ujit. Ajo thekson se “termocentralet me qymyr prodhojnë mbetje të rrezikshme, si hiri toksik, i cili ndot burimet ujore dhe tokën bujqësore”, ndërsa energjia e rinovueshme eliminon këto probleme mjedisore.

Sipas saj, kalimi në burime të pastra të energjisë është gjithashtu një hap i rëndësishëm në luftën kundër ndryshimeve klimatike. “Kosova emeton një sasi të lartë të CO₂ për shkak të varësisë nga qymyri, dhe tranzicioni drejt energjisë diellore dhe të erës mund të ndihmojë në përmirësimin e objektivave të Marrëveshjes së Parisit”, thotë ajo.

Mundësi dhe sfida, bashkëpunimi ndërkombëtar për energjinë e rinovueshme në Kosovë

Kur u pyet për rolin e bashkëpunimit ndërkombëtar në zhvillimin e energjisë së rinovueshme në Kosovë, profesoresha tha se ekspertët theksojnë se ai është një faktor kyç për përshtetimin e tranzicionit energjetik të vendit. Veseli argumenton se institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore, BERZH dhe BEI, mund të ofrojnë fonde thelbësore për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së pastër. “Nëse Kosova arrin të sigurojë financim nga këto institucione, mund të shohim një rritje të ndjeshme të projekteve të energjisë diellore dhe të erës”, tha ajo.

Ajo shton se programet e BE-së, si IPA dhe Horizon Europe, ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për projektet inovative në energjinë e rinovueshme. Sipas saj, ky është një aspekt thelbësor për tërheqjen e investimeve private dhe krijimin e një tregu të qëndrueshëm energjetik. Ndër të tjera, Kosova ka nevojë për partneritete me vende me përvojë të gjatë në energjinë e pastër, si Gjermania dhe Danimarka. “Këto shtete mund të ndihmojnë jo vetëm me teknologjinë, por edhe me trajnimin e ekspertëve vendas”, shtoi ajo. Përveç kësaj, bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet kërkimore ndërkombëtare mund të ndihmojë në zhvillimin e inovacioneve dhe praktikave të reja për ruajtjen dhe shpërndarjen e energjisë.

“Nëse Kosova bëhet pjesë e tregut rajonal të energjisë, do të mund të eksportoje energji të pastër dhe të sigurojë një furnizim më të qëndrueshëm”, vë në theks profesoresha. Gjithashtu, marrëveshjet me vendet fqinje për ndarjen e kapaciteteve energjetike mund të ndihmojnë në menaxhimin më efikas të kërkesës dhe ofertës gjatë periudhave të ndryshme të vitit. Por, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është pa sfida. Një nga pengesat më të mëdha mbetet statusi politik i Kosovës. “Disa organizata ndërkombëtare ende nuk mund të ofrojnë mbështetje të plotë për shkak të mosnjohjes së Kosovës”, u shpreh profesoresha.

Nëse Kosova arrin të kapërcejë këto sfida dhe të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar, ajo mund të shndërrohet në një lider rajonal të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, kjo kërkon një angazhim të fortë politik, reforma të thella dhe një strategji afatgjatë për të integruar energjinë e pastër në sistemin energjetik të vendit.

"Nëse Kosova bëhet pjesë e tregut rajonal të energjisë, do të mund të eksportoje energji të pastër dhe të sigurojë një furnizim më të qëndrueshëm".

Realiteti gjeopolitik dhe sfidat e krijimit të ushtrisë evropiane



OPINION

"Shtetet e Bashkuara kanë qenë historikisht garancia kryesore për sigurinë europiane, por me rikthimin e Presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë, Europa përballet me një realitet të ri. Administrata e tij e sheh botën si një arenë ku fuqia ushtarake dhe aftësia për të imponuar vullnetin përcaktojnë rendin ndërkombëtar. Për këtë arsye, ShBA-ja po e zvogëlon angazhimin e saj në Europë, duke i lënë vendet e kontinentit të përballen vetë me kërcënimet e jashtme."

Prof. Ass. Dr. Alfred MARLEKU



Deklarata e Presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, e shprehur në Konferencën për Siguri të Mynihut mbi domosdoshmërinë e krijimit të një "ushtrie evropiane" ka rikthyer në skenë një debat të hershëm mbi autonominë strategjike të Evropës. Kërkesa e tij vjen në një epokë komplekse gjeopolitike, ku roli i Shteteve të Bashkuara në mbrojtjen e kontinentit po vihet gjithnjë e më shumë në dyshim, sidomos pas ndryshimeve të mëdha në politikën e jashtme amerikane të artikuluar nga administrata Trump.

Shtetet e Bashkuara kanë qenë historikisht garancia kryesore për sigurinë evropiane, por me rikthimin e Presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë, Evropa përballet me një realitet të ri. Administrata e tij e sheh botën si një arenë ku fuqia ushtarake dhe aftësia për të imponuar vullnetin përcaktojnë rendin ndërkombëtar. Për këtë arsye, ShBA-ja po e zvogëlon angazhimin e saj në Evropë, duke i lënë vendet e kontinentit të përballen vetë me kërcënimet e jashtme. Kjo zhvendosje ka nxitur disa liderë evropianë të propozojnë krijimin e një ushtrie të përbashkët evropiane, por një projekt i tillë ndeshet me pengesa të mëdha.

Së pari, një ushtri e tillë do të kërkonte unanimitet mes 27 shteteve anëtare të BE-së, gjë që është jashtëzakonisht e vështirë për t'u arritur, duke marrë parasysh ndasitë e thella politike, interesat e ndryshme kombëtare dhe orientimet strategjike diverse të shteteve. Në këtë kontekst, vende si Polonia dhe Hungaria kundërshtojnë centralizimin ushtarak në një strukturë institucionale evropiane, duke argumentuar se NATO-ja duhet të mbetet mbrojtësi kryesor i kontinentit. Nga ana tjetër, shtete neutrale si Austria, Irlanda apo Malta nuk do të pranonin të përfshihen në një strukturë të tillë ushtarake. Për më tepër, shumë vende të Evropës Lindore e shohin ShBA-në si aktorin vital dhe garantuesin kryesor të sigurisë së tyre, ndaj nuk do të mbështesnin një reduktim të rolit amerikan në rajon.

Një sfidë tjetër është përputhja e industrive të mbrojtjes dhe pajisjeve ushtarake mes vendeve anëtare. Aktualisht, shtetet evropiane përdorin 17 lloje të ndryshme tankesh dhe mbi 20 lloje avionësh luftarakë. Çdo përpjekje për standardizim do të kërkonte investime të mëdha financiare dhe një proces të gjatë adaptimi. Për më tepër, çështja e kontrollit politik dhe komandës mbetet



problematike: cili institucion do ta drejtonte këtë ushtri? A do të ishte në varësi të Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian apo Komisionit Evropian? Disa shtete nuk do të pranonin që trupat e tyre ushtarake të përdreshin në konflikte ku nuk janë drejtpërdrejt të përfshira, gjë që do ta bënte të vështirë krijimin e një force të unifikuar.

Një tjetër pengesë e madhe për krijimin e një ushtrie evropiane është mungesa e një strategjie të përbashkët mbrojtëse. Vendet evropiane kanë interesa të ndryshme dhe perceptime të diverse mbi kërcënimet dhe rreziqet me të cilat përballen. Ndërsa vendet e Evropës Lindore shqetësohen kryesisht për agresionin rus, duke e renditur atë si kërcënimin kryesor në strategjitë e tyre të sigurisë kombëtare, shtetet e Evropës Jugore janë më të përqendruara në sigurinë kufitare dhe menaxhimin e migracionit të paligjshëm, kotrabanës dhe trafikimin me qenie njerëzore. Kjo mospërputhje e prioriteteve e bën të vështirë krijimin e një strategjie të unifikuar ushtarake dhe të një force që mund të veprojë në mënyrë efektive.

Një vështirësi madhore është edhe financimi i një ushtrie të tillë. Aktualisht vetëm disa vende evropiane

kanë arritur pragun e shpenzimeve prej 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto për mbrojtjen, një standard i vendosur nga NATO-ja. Krijimi i një ushtrie të re do të kërkonte një buxhet të madh dhe investime të konsiderueshme në teknologji dhe infrastrukturë ushtarake, çka është vështirë e realizueshme për shumicën e vendeve të BE-së që përballen me sfida të mëdha ekonomike. Ndërsa Franca dhe Gjermania mund të kenë një orientim strategjik për të rritur shpenzimet e tyre ushtarake, shumë vende më të vogla nuk kanë kapacitetin ekonomik për të kontribuar në të njëjtin nivel.

Për më tepër, krijimi i një ushtrie evropiane mund të shkaktojë tensione me NATO-n. Me 23 nga 27 vendet e BE-së që janë gjithashtu pjesë e NATO-s, një ushtri e pavarur evropiane mund të shihet si një përpjekje për të ulur varësinë nga NATO-ja, çka mund të krijojë një rivalitet potencial brenda vetë aleancës. Kjo mund të dobësojë bashkëpunimin strategjik mes ShBA-së dhe Evropës, duke e bërë këtë të fundit më të ekspozuar ndaj kërcënimeve të jashtme.

Prandaj, përpjekjet për të krijuar një ushtri evropiane duken më shumë si një manovër politike sesa një plan

realist për mbrojtjen e kontinentit. Politikbërësit evropianë mund të synojnë të projektojnë një imazh të pavarësisë nga ShBA-ja, por realiteti është se siguria e Evropës do të mbetet e lidhur ngushtë me NATO-n dhe Uashingtonin edhe për një kohë. Në vend që të ndjekin një iluzion politik, liderët evropianë duhet të përqendrohen në forcimin e kapaciteteve të tyre mbrojtëse brenda kornizës së NATO-s dhe të sigurohen që aleanca të mbetet e fortë dhe funksionale.

Në fund të fundit, fuqia mbetet faktori kryesor që përcakton marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në këtë sistem anarkik, ku mungon një autoritet qendror, shtetet do të vepronin gjithmonë në bazë të interesave të tyre kombëtare. Në këto rrethana gjeopolitike, krijimi i një ushtrie evropiane është vështirë i arritshëm. Në një periudhë të multipolaritetit ndërkombëtar, Evropa ka nevojë për një politikë realiste të sigurisë, jo për një eksperiment të paqartë që mund të krijojë më shumë probleme sesa zgjidhje.

Dea BERISHA

TOP NEWS: LAJMET E SHKURTIT



Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025: Në këtë datë u mbajtën zgjedhjet e rregullta parlamentare në Kosovë. Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, fitoi rreth 40% të votave, por nuk arriti shumicën absolute në Kuvendin e Kosovës.




Kosova shënoi 17-vjetorin e pavarësisë së saj, të shpallur më 17 shkurt të vitit 2008. Qeveria e vendit mbajti një mbledhje festive, në të cilën kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, shprehu mirënjohje dhe nderime për "të gjithë ata që u sakrifkuan dhe u flijuan" për lirinë.



Dhomat e Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, më 4 shkurt, kanë shpallur fajtorë dhe kanë dënuar Haxhi Shalën, Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin, lidhur me akuzat që kanë të bëjnë me pengim të drejtësisë. Kështu trupi gjykoes pranoi marrëveshjen e fajësisë që të akuzuarit arritën më herët me Prokurorinë e Specializuar.




Shqipëria dhe Serbia do të jenë bashkëorganizatore të Kampionatit Evropian të futbollit për nën 21-vjeçarët në vitin 2027. Më 4 shkurt, UEFA konfirmoi se ky kampionat do të organizohet nga dy shtetet e Ballkanit Perëndimor.




Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), më 7 shkurt, i ka dënuar ato që i ka quajtur "sulme të vazhdueshme" të kryeministrit të Kosovës dhe partisë së tij në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj mediave dhe gazetarëve gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.



Misioni vëzhgues i Bashkimit Evropian (BE) i ka vlerësuar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë si pozitive dhe të qeta, por me disa të meta. Gjuha negative dhe nxitëse e partisë në pushtet ndaj medias dhe gjyqësorit, ndërhyrja e Serbisë përmes trysnisë ndaj votuesve serbë të Kosovës, si dhe kritikën e një zyrtari amerikan ndaj kryeministrit Albin Kurti gjatë fushatës, ishin disa nga çështjet që u përmendën në konferencën për media të martën, në Prishtinë.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka ngulur këmbë se integriteti i votës nuk është cenuar dhe se rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, do të jenë të sakta, pavarësisht dyshimeve të ngritura pas vonësve gjatë numërimit të votave.



Prokuroria Speciale i ka bërë kërkesë Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 19 shkurt, ta urdhërojë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, të paraqitet në Prokurori në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore, pasi Kurti kishte refuzuar dy ftesat e mëparshme.



Më 1 shkurt 2025, Presidenti amerikan Donald Trump njoftoi tërheqjen e Shteteve të Bashkuara nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar se ky organ nuk është duke e kryer punën e tij si duhet. Ai gjithashtu zgjati vendimin për pezullimin e ndihmës financiare për Agjencinë e OKB-së për Refugjatët Palestinezë dhe urdhëroi një rishikim të rolit amerikan në UNESCO.




Gjykata e Lartë Federale e Irakut ka pezulluar përkohësisht zbatimin e tre ligjeve të miratuara nga parlamenti muajin e kaluar, përfshirë një ligj që ndryshon ligjin e statusit personal dhe që aktivistët thonë se kërcënon të drejtat e grave.



Aktiviteti sizmik në Santorini ka arritur nivele alarmante, me mbi 6,400 tërmete të regjistruara midis ishujve Santorini dhe Amorgos nga 26 janari deri më 3 shkurt, sipas Komitetit Ndërdisciplinor për Menaxhimin e Rrezikut dhe Krizave të Universitetit Kombëtar të Athinës.



Izraeli ka njoftuar tërheqjen nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (UNHRC), duke ndjekur shembullin e Shteteve të Bashkuara. Ministri i Jashtëm izraelit, Gideon Saar, e bëri të ditur vendimin përmes një postimi në X, duke akuzuar Këshillin për trajtim të padrejtë ndaj Izraelit dhe për fokus disproporcional ndaj tij në raport me vendet e tjera.




Konsumatorët në Evropën Juglindore kanë nisur një valë bojkotesh ndaj supermarketeve për shkak të rritjes së çmimeve, një fenomen që ka nisur në Kroaci dhe është përhapur në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Bullgari dhe Serbi. Kjo lëvizje është organizuar kryesisht përmes rrjeteve sociale dhe është mbështetur nga sindikatat, grupet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe disa politikanë.



SHBA dhe Rusia sapo kanë zënë vendet e tyre në tryezën e Riadit, për të dhënë fund luftës në Ukrainë, por në këto bisedime mungon një vend kyç: Ukraina. Megjithatë ky nuk është fillimi i negociatave të paqes – siç dëshiron të theksojë SHBA-ja – është shumë në vijën e shikimit.




Aleanca konservatore e Gjermanisë CDU/CSU, e udhëhequr nga Friedrich Merz, i ka fituar zgjedhjet e së dielës për Qeverinë e re federale, me 28.5 – 29 për qind të votave, sipas sondazheve të para televizive.



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, është arrestuar të hënën në dyshimin për korrupsion dhe shpëlarje parash, njoftoi Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK).

Redaksia e UBT News ju rekomandon këtë muaj të shihni një përzgjedhje filmash të vjetër shqiptarë



Kush vdes në këmbë (1988)
 Një film historik mbi rezistencën shqiptare kundër pushtimit të huaj. Me një narrativë të fortë dhe personazhe të spikatura, filmi është një homazh për ata që zgjedhin të luftojnë deri në fund për lirinë e tyre.



Gjeneral Gramafoni (1978)
 Një film me një mesazh të fortë kulturor dhe historik, që tregon përhapjen e muzikës shqiptare dhe rezistencën ndaj pushtimit fashist. Historia e një tregtari gramafonësh dhe ndikimi i tij në shoqëri e bëjnë këtë film unik dhe të paharrueshëm.



Nëntori i dytë (1982)
 Një film historik që rikthen në jetë momentet e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912. Me skena mbresëlënëse dhe një rrëfim të fuqishëm, ai mbetet një nga filmat më të rëndësishëm kombëtarë.



Dora e ngrohtë (1983)
 Një dramë sociale që trajton sfidat e një familjeje shqiptare në një periudhë tranzicioni. Historia fokusohet në marrëdhëniet njerëzore dhe sakrificat për të mbajtur familjen të bashkuar.



Lulëkuqet mbi mure (1976)
 Një dramë sociale që pasqyron jetën e disa fëmijëve në një shtëpi korrektuese. Filmi trajton çështje si edukimi, ndëshkimi dhe nevoja për dashuri dhe përkujdesje. Ai mbetet një nga filmat më të rëndësishëm në kinematografinë shqiptare.



Beni ecën vetë (1975)
 Një nga filmat më të dashur për fëmijë në Shqipëri, ai ndjek rrugëtimin e Benit, një djalë të vogël i cili mëson të jetë i pavarur. Filmi ka një mesazh të rëndësishëm për rritjen dhe përgjegjësinë personale.



Përrallë nga e kaluara (1987)
 Një komedi e dashur që trajton martesën, moralin dhe jetën familjare në një periudhë të shkuar. Me humor të hollë dhe mesazhe të thella shoqërore, ai mbetet një nga filmat më të dashur për publikun shqiptar.



Tana (1958)
 I pari film artistik shqiptar i prodhuar pas Luftës së Dytë Botërore, "Tana" paraqet sfidat e një vajze të re që përpiqet të kapërcejë paragjykimet dhe të ndjekë ëndrrat e saj. Filmi eksploron temat e emancipimit dhe zhvillimit shoqëror në një periudhë ndryshimesh të mëdha në Shqipëri.



14 vjeç dhëndërr (1987)
 Një nga komeditë më të njohura të kinematografisë shqiptare, me një narrativë të mbushur me humor, por që trajton një çështje të rëndësishme shoqërore: martesat e hershme dhe ndikimi i mentalitetit tradicional në jetën e të rinjve.

Shkurti në UBT News me edicionin e tretë të revistës digjitale

UBT NEWS

Në përmbyllje të këtij edicioni të tretë të revistës digjitale UBT News, e cila publikohet më datë 31 të çdo muaji, ne ndiejmë krenari të thellë për përkushtimin dhe kreativitetin që ka karakterizuar punën e gjithë redaksisë. Çdo numër i revistës do të jetë një thirrje për të shikuar botën përtej sipërfaqes, për të gërmuar thellë në kompleksitetet që na rrethojnë dhe për të ofruar një perspektivë të pasur dhe të ndjeshme për ngjarjet dhe fenomenet që na prekin.

Ky edicion është një pasqyrë e përkushtimit për të ndihmuar lexuesit të zhvillojnë një kuptim më të thellë të botës, përmes artikujve që shpalosin mendime të guximshme, analiza të hollësishme dhe ide të reja që sfidojnë paradigmat e zakonshme. Në këtë edicion u përfshinë tema që reflektojnë aktualitetin politik, social, kulturor dhe

shkencor, duke krijuar një hapësirë për lexuesit që të shqyrtojnë realitetin me një mendje të hapur dhe vëmendje të thellë.

Redaksia e UBT News është e përbërë nga redaktorja Dionesa Ebibi, gazetarët Dea Berisha, Fjolla Gashi, fotografe

Manushaqe Ibrahim, drejtor kreativ Halil Ponik dhe kameramani Arianit Hasani.

Në këtë mundësi, dëshirojmë të shprehim një falënderim të thellë dhe të sinqertë për të gjithë bashkëpunëtorët, profesorët dhe ekspertët, të cilët kanë kontribuar me profesionalizmin e tyre në realizimin e këtij projekti.

Angazhimi i tyre ka qenë thelbësor për suksesin e këtij numri, dhe ne jemi të nderuar që kemi pasur mundësinë të punojmë së bashku.

Rikthejmë këngët më të bukura shqipe...



**Engjujt
nuk jetojnë
në tokë**


GRUPI 403

Engjujt nuk jetojnë në tokë



MINATORI

A thua ëndërr ishe ti



MUHARREM QENA

Mallëngjimi



TROJA

Amaneti i Clown-it



AGRON BERISHA

Ëndërr



GJURMËT

GJURMËT

Ty



NEXHMIJE PAGARUSHA

Vetë ke mbetë